



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.93/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Pejë, për shkak të vendosjes së posterit në trafostacion elektrik të posterit të kandidatit për kryetar komune dhe të kandidatëve për anëtar të kuvendit komunal në Pejë, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 03.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dhe subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 1,300.00 (njëmij e treqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

A r s y e t i m

Me datën 28.09.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me të cilën pretendon se me datën 28.09.2017 në rrugën Adem Jashari në Pejë tek soliterat kanë hasur posterin e kandidatit për kryetar të komunës së Pejës dhe të kandidatëve për këshilltar komunal nga subjekti politik LDK të vendosur në një trafostacion elektrik. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës 13/2014.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 29.09.2017, subjekti politik LDK, thekson se degët dhe kandidatët e saj janë udhëzuar që të mos përdorin postera gjatë fushatës zgjedhore, dhe se vendosja e tyre mund të jetë bërë nga vullnetarë të cilt janë familjarizuar me rregullat përkatëse dhe se shtabi lokal i degës në Pejë është njoftuar që ti evitoj dhe se i njëjti ka ndërruar veprime duke i larguar ato.

Si dëshmi ka bashkangjitur fotografit me të cilat shihet se është larguar posterit nga vendi ku ka qenë i vendosur.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posteri reklamues i kandidatit të LDK-së për kryetar të komunës së Pejës dhe të anëtarëve të kuvendit komunal nga ky subjekt politik është vendosur trafostacionin elektrik gjegjësisht në objekte dhe në hapsira publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton: *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në objekte dhe në hapsira publike.*

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik LDK, është shkëlur neni 33 pika (b) të LZP-së, pasi që posteri reklamues i kandidatit për kryetar komune në Pejë dhe anëtarëve të kuvendit komunal nga subjekti politik në fjalë, është vendosur në hapsirë dhe në objekt publik, të cilën shkëlje e ka pranuar edhe vet subjekti politik LDK në përgjigjen në ankes të datës 29.09.2017

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik LDK, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thot se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se përkundër këtij fakti posteri reklamues i subjekti politik LDK është vendosur në trafostacionin elektrik. Poashtu si rrethanë Paneli mori edhe faktin se subjektit politik në fjalë ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërrmar veprime për të bërë përmisimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr posterin nga vendi i palejuar ku ka qenë i vendosur ai, i cili veprim ka ndikuar në lartësin e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL. Anr.93/2017 më datën 03.10.2017.

Kryesuesi i Panelit

Hasan Shala

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.